



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:018016
Datë: 12.04.2024
Numri i dokumentit: 05566243

E.nr.1283/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorëve N.H. dhe G.H., të cilët i përfaqëson av Nazmije Ibrahimimi nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Shtimes – Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit, shpërblimit jubilar dhe shpenzimet e procedurës, më datë 12.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.1283/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1283/22, të datës 13.09.2022, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve, kundër debitorit Komuna e Shtimes – Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit, shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit C.nr.133/21, të datës 05.05.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 02.11.2022, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,284.17 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.1283/23, më datë 12.04.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi